



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Ligjshmërisë

RELACION
PËR
VENDIMIN
PËR

RREGULLAT PROCEDURALE PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT
ELEKTRONIK NËPËRMJET PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE
NUMËRIMIT (PEVN) PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pikat 2, shkronja “e” dhe 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë, si dhe projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi.

Neni 22, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ-ja ka kompetencë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte dhe/ose procedura të veçanta të procesit zgjedhor, të angazhojë konsulencë të huaj për këtë qëllim, si dhe të prokurojë sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit apo edhe shërbimin e operimit të tyre. KQZ-ja është e detyruar që përdorimin e sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit ta zbatojë në zgjedhje nëpërmjet projekteve pilot, në jo më pak se 10 për qind të numrit të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat procedurale për procesin e votimit të zgjedhësve në qendrat e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) si dhe nxjerrjen e rezultatit nga SEMVR.

Ky projektvendim ka për objekt të përcaktojë:

- a. Procedura e dorëzimit të PEVN-ve, KZAZ-ve përkatëse , ku do të pilotohet votimi dhe numërimi elektronik, nga ana e KQZ-së;

- b. Si procedohet në rastet kur votimi elektronik nuk mund të fillojë/është ndërprerë/nuk vijon, për arsye teknike që lidhen me PEVN;
- c. Rastet e veçanta, kur votimi kryhet me ndihmën e një familjari/zgjedhësi tjetër të asaj QV-je;
- d. Mbyllja e procesit të PEVN-ve dhe transmetimit të të dhënave nga ana e personelit teknik të ngarkuar nga KQZ-ja për përdorimin e PEVN;
- e. Të dhënat që transmetohen nëpërmjet modemit USB nga PEVN;
- f. Dorëzimi i pajisjeve pas përfundimit të procesit;
- g. Procedura e numërimit të votave nga SEMVR dhe nxjerrja e rezultatit.

Ky projektvendim përcakton procedurën e dorëzimit të PEVN-ve KQV-ve përkatëse, ku do të pilotohet votimi dhe numërimi elektronik, nga ana e KQZ-së, së bashku me kutitë shoqëruese, që mundësojnë votimin elektronik, procesverbalet dhe dokumentacionin e punës të përshtatur.

Hapja e procesit të votimit nëpërmjet PEVN kryhet nga personeli teknik, i ngarkuar nga KQZ-ja.

Në rastet kur votimi elektronik për arsye teknike që lidhen me PEVN, nuk mund të fillojë, apo pasi ka filluar është ndërprerë dhe nuk mund të vijojë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos mbi vijimin e procedurës së votimit me fletë votimi.

Në rastet kur zgjedhësi, për arsye fizike, nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit elektronik, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur kryhet kjo procedurë.

Personeli teknik i ngarkuar nga KQZ-ja për përdorimin e PEVN, në përfundim të votimit, kryen mbylljen e procesit në PEVN. PEVN-ja printon automatikisht raportin e mbylljes me rezultatin përkatës, i cili bie në kutinë shoqëruese që mundëson votimin elektronik.

Pasi është mbyllur procesi i mësipërm, personeli teknik i ngarkuar nga KQZ-ja për përdorimin e PEVN, vendos në një nga portat USB të PEVN, modemit USB me kartë SIM, i cili mundëson transmetimin e rezultatit të PEVN në SEMVR. Ky modem konfigurohet vetëm nga stafi i KQZ.

Të dhënat që do të transmetohen nëpërmjet modemit USB, janë:

- a. Kodi unik i identifikimit të PEVN.
- b. Numri total i fletëve elektronike të votimit.
- c. Numri i fletëve elektronike të votimit të vlefshme.
- d. Numrin e fletëve elektronike të votimit në të cilat nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit .
- e. Numrin e votave elektronike për çdo kandidat.

Të gjitha të dhënat transmetohen në një format të sigurt dhe të pandryshueshëm nëpërmjet certifikatave dhe çelësave të enkriptuar nga PEVN drejt SEMVR, informacion që aksesohet vetëm nga stafi i KQZ.

Në rastet kur transmetimi, për arsye teknike që lidhen me PEVN ose me modemin nuk ndodh, procesi i nxjerrjes së rezultateve do të kryhet manualisht.

Rezultati paraprak nxirret dhe publikohet, pasi është dërguar në KQZ, rezultati i votimit për çdo qendër votimi, ku zbatohet projekti pilot.

Në përfundim të procesit të votimit, KQV-të dorëzojnë pranë VNV pajisjet PEVN, së bashku me materiale të tjera zgjedhore.

Në vijimësi, KZAZ-ja në prani të vëzhguesve, kryen procesin e numërimit të votave në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR), sipas procedurave teknike dhe operacionale të përcaktuara me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. SEMVR do të kryejë përlllogaritjen e rezultatit dhe do të shfaqë në monitor e do të printojë në letër tabelat e rezultateve për çdo PEVN, QV si dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve.

Tabelat e rezultateve, për çdo Qendër Votimi dhe në nivel ZAZ, firmosen nga anëtarët e KZAZ-së. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve miratohet me vendim nga KZAZ-ja.

Ky projektvendim nuk paraqet kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin “Për rregullat procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”.

Daniela Alimemeti

-Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Pavlina DOÇAJ

- Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: __.04.2025

Nr: __

Ora:

V E N D I M

P Ë R

MIRATIMIN E RREGULLAVE PROCEDURALE PËR PROCESIN E
VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK ME ANË TË PAJISJES
ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT (PEVN) NË
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “c”, pika 2, shkronja “c”, neni 22, pika 1 e 3 , të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, të zbatohet projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave me anë të pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), në të gjitha Qendrat e Votimi (QV) në Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ-të) nr. 41 dhe nr. 27 të qarkut Tiranë, të përcaktuara në vendimin nr. 13, datë 28 shkurt 2025, të Komisionit Rregullator.
2. Çdo qendër votimi (QV) në Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ-të) nr. 41 dhe nr. 27 të qarkut Tiranë të këtë dy pajisje elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) që mundësojnë votimin dhe numërimin elektronik në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025.
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve udhëzon me akt të veçantë anëtarët e KZAZ-ve dhe KQV-ve nën juridiksionin e tyre, për veprimtaritë operacionale që lidhen me marrjen në dorëzim dhe kthimin e bazës materiale zgjedhore.
4. KQZ-ja i dorëzon KZAZ-ve dhe më tej nga KZAZ-ja në KQV:
 - a) Materialet zgjedhore që përdoren për procedurat të cilat nuk janë të automatizuara, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. 5 datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, i ndryshuar.
 - b) PEVN-të me kutitë shoqëruese që mundësojnë votimin elektronik, si dhe procesverbalet dhe dokumentacionin e punës të përshtatur për këtë proces.

Data: __.__.2025 Nr:
Ora: __:__



Për miratimin e rregullave procedurale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik me anë të pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN).

5. Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV), për procedurat të cilat nuk janë të automatizuara, zbaton rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 11, datë 25 mars 2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, të ndryshuar, ndërsa për procedurat e votimit dhe numërimit elektronik vepron në përputhje me aktet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të Komisionit Rregullator.
6. Vënia në funksion e PEVN-ve, kryhet në qendrën e votimit, përpara hapjes së votimit, në prani të anëtarëve të KQV-së dhe të vëzhguesve të subjekteve, nga operatori teknik i PEVN-së, i caktuar nga KQZ.
7. Operatori teknik i ngarkuar për përdorimin e PEVN, nëpërmjet kartave smart dhe kodeve përkatës bën hapjen e PEVN-ve duke printuar dhe dorëzuar KQV-së raportet e hapjes së votimit të cilët tregojnë orën e hapjes, numrin e QV-së dhe të pajisjes si dhe 0 (zero) pjesëmarrës në votim. Këto raporte printohen në 8 kopje, firmosen nga anëtarët e KQV-së dhe vulosen. Një kopje i dorëzohet sekretarit për ta ruajtur si material zgjedhor, një kopje e merr operatori teknik, kopjet e tjera u dorëzohen anëtarëve të tjerë të KQV-së.
8. Një nga anëtarët e KQV-së ngarkohet nga komisioni për të kryer procesin e aktivizimit për votim të dy PEVN-ve në çdo QV nëpërmjet butonit të tipit pulsant, nga një për secilën pajisje. Anëtarë i KQV-së i ngarkuar me këtë detyrë, nëpërmjet butonave të tipit pulsant, aktivizon në mënyrë manuale PEVN-të për votim në kohën kur votuesi, pasi ka kryer me sukses procesin e identifikimit në PEI, shkon tek PEVN për të votuar.
9. Në rastet kur votimi elektronik për arsye teknike që lidhen me PEVN, nuk mund të fillojë, apo pasi ka filluar është ndërprerë dhe nuk mund të vijojë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos mbi vijimin e procedurës së votimit me fletë votimi sipas vlerësimit të situatës nga ana e tij.
10. Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit elektronik, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
11. Në përfundim të procesit të votimit, pasi KQV ka marrë vendimin për mbylljen e votimit, i kërkohet operatorit teknik të kryejë mbylljen e procesit të votimit në pajisjet PEVN. Fillimisht printohet raporti i rezultatit me QR kod për çdo PEVN, cili bie brenda në kutitë shoqëruese të votimit të secilës pajisje PEVN. Pastaj operatori kalon pajisjen në modalitet printimi dhe printon raportin e mbylljes së votimit në 8 (tetë) kopje, që firmoset nga anëtarët e KQV-së, vulosen dhe i dorëzohet sekretarit dhe anëtarëve të KQV, si dhe 1(një) kopje operatorit teknik. Gjithashtu, printohet dhe raporti e rezultatit për çdo PEVN në 8 (tetë) kopje dhe i dorëzohet nga një kopje sekretarit dhe anëtarëve të KQV-së dhe operatorit teknik. Sipas kërkesave të paraqitura nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore apo vëzhguesit pranë KQV-së, operatori teknik mund të printojë kopje të tjera të raportit e rezultateve të votimit për çdo PEVN. Raporti i rezultatit dhe raporti i mbylljes së votimit përmbajnë të dhëna për KZAZ-në, QV-në, numrin e zgjedhësve që kanë votuar. Përveç kësaj, raporti i rezultatit përmban rezultatin e zgjedhjeve për atë pajisje edhe QR kodin.

12. Vetëm pasi është mbyllur procesi i votimit në secilën PEVN dhe janë printuar raportet sipas pikës 11 të këtij vendimi, operatori teknik i ngarkuar nga KQZ-ja për përdorimin e PEVN-së vendos në një nga portat USB (ang.) të PEVN-ve modemën e transmetimit USB me kartë SIM, i cili mundëson transmetimin e rezultatit paraprak të PEVN në SEMVR (Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve). Ky modem konfigurohet vetëm nga stafi përgjegjës i KQZ.
13. Të dhënat që do të transmetohen nëpërmjet modemit USB, janë:
 - a. Kodi unik i identifikimit të PEVN-së.
 - b. Numri total i votave elektronike.
 - c. Numri i votave elektronike të vlefshme.
 - d. Numri i votave elektronike në të cilat nuk është votuar për asnjë nga kandidatët/subjektet zgjedhore në fletën e votimit.
 - e. Numri i votave elektronike për çdo kandidat/subjekt zgjedhor.
14. Të dhënat transmetohen në një format të sigurt dhe të pandryshueshëm nëpërmjet certifikatave dhe çelësave të enkriptuar nga PEVN drejt SEMVR. Informacioni që do të transmetohet nga PEVN drejt SEMVR aksesohet vetëm nga stafi përgjegjës i KQZ-së.
15. Në rastet kur transmetimi për arsye teknike që lidhen me PEVN ose me modemën nuk ndodh, procesi i nxjerrjes së rezultateve paraprake do të kryhet sipas procedurave teknike dhe operacionale të përcaktuara me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
16. Rezultati paraprak nxirret dhe publikohet nga KQZ, pasi është dërguar në SEMVR rezultati i votimit për çdo qendër votimi ku zbatohet projekti pilot.
17. Pas mbylljes së votimit, KQV-të dorëzojnë në KZAZ pajisjet PEVN, së bashku me materiale të tjera zgjedhore.
18. Pas dorëzimit nga të gjitha KQV-të pranë KZAZ-së të pajisjeve dhe materialeve përkatëse, KZAZ-ja në prani të vëzhguesve, kryen procesin e numërimit të votave në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR), sipas procedurave teknike dhe operacionale të përcaktuara me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
19. SEMVR do të kryejë përlllogaritjen e rezultatit dhe do të printojë në letër tabelat e rezultateve për çdo QV si dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, sipas modeleve të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
20. Procesi i nxjerrjes së rezultateve përfundimtare për çdo QV realizohet nga KZAZ-ja në ambientin e VNV-së.
21. Tabelat e rezultateve, si për QV dhe në nivel ZAZ, firmosen nga anëtarët e KZAZ-së. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve miratohet me vendim nga KZAZ-ja.
22. Në rastin kur procedura e votimit është zhvilluar në njërin pjesë të ditës elektronikisht dhe në një pjesë tjetër të ditës manualisht, KZAZ aktivizon GNV-të të ndjekin procedurat standarde për hapjen e kutive të votimit, numërimin, vlerësimin dhe nxjerrjen e rezultateve sipas udhëzimeve të KQZ- së vetëm pasi sistemi ka gjeneruar raportin me rezultatet e votimit për pjesën elektronike.
23. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për informimin e zgjedhësve dhe të administratës zgjedhore në lidhje me përdorimin e PEVN-së.

24. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
25. Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
26. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO- **Kryetare**

Arens ÇELA- **Anëtar**

Dritan ÇAKA- **Anëtar**

Helga VUKAJ- **Anëtare**

Muharrem ÇAKAJ - **Anëtar**